



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.929/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lart Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, Bajram Sokoli, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, dega në Viti, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, Bajram Sokoli nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë dega në Viti, me shenjën ZL.Anr.929/2017 të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë dega në Viti, me të cilën ka pretenduar se ekziston mundësia e manipulimit me vota të tij në fshatin Buzovik, në vendvotimet 2612d/01R, i ka poseduar 4 vota në FRK, por tani i posedon vetëm 3 vota. Po ashtu edhe në qendrat e votimit 2617d, në fshatin Smire në VV nr.02R, në QV nr.2617d, në vendvotimin 02R kanë votuar votues. Më tutje ka shtuar se edhe në Qendrën e Votimit 2602d në VV nr.01D ka vetëm 2 vota dhe pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja sipas FRK ka poseduar 253 vota ndërkajë sipas KQZ tani i figurojnë 251 vota. Në QV nr.2617D/02r, 2602D/01D, 260D/02R, 2612D/01D, 2611D, 2607d/03d, 2607d/02R, ka kërkuar që ti rinumërohen votat.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar.

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve në apel gjeti se parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur dëshmi lidhur me pretendimet e parashtruara në apel. Prandaj, apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë apelin e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.929/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*